



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 51 prot

Tiranë, më 09.01.2024

VENDIM

Nr. 02, datë 09.01.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesit, banorët e fshatit Mezhgoran z. , z. , z. , z. dhe z. , përfaqësuar nga av. , (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2138 Prot., datë 02.11.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tepelenë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës së datës 26.10.2023, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni lidhur me:

1. Lejen për përdorim të burimit Ujor nga Këshilli i Basenit Ujor Vjosë për burimin ujor të fshatit Mezhgoran lidhur me projektin e miratuar për ndërtimin e ujësjellësit Mezhgoran Peshtan.
2. Projektin e miratuar për ujësjellësin Mezhgoran Peshtan.
3. Vendimin e Këshillit Bashkiak për ndërtimin e Ujësjellësit Mezhgoran Peshtan.
4. Procesverbalet e konsultimit publik me banorët e fshatit Mezhgoran ku të jenë shënuar qartësisht mendimet dhe pretendimet e tyre.
5. Një kopje të dokumentacionit të kompanive “2 T” dhe “GPG Company” në bazë të të cilit ato dy kompani kryejnë punime.

Autoriteti Publik, mbështetur në përgjigjen e datës 20.10.2023, në të cilën i bën me dije ankuesit të specifikoj dokumentacionin e kërkuar, në mënyrë të tillë që bazuar në VKB nr. 92, datë 25.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë” të përlogarit tarifa dhe pas pagesës së saj do t’i vihet në dispozicion informacioni i kërkuar. Në vijim, ankuesi pretendon se Autoriteti Publik i ka dërguar një faturë për arkëtim me nr. 168, datë 14.11.2023, duke vendosur shumë që duhet paguar, në përgjigje të kërkesës objekt shqyrtimi.

Pas përgjigjes së sipërcituar, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 194, datë 01.12.2023, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 06.12.2023.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e Autoritetit Publik sqaruan se: *“Informacioni në vlerësimin e drejtorisë i është dhënë i specifikuar kërkuarit, ndërsa sa i përket dhënies së dokumentacionit fizik si dhe në referencë të prokurës noteriale për mbrojtje në Gjykatë të të 5 banorëve të përfaqësuar nga avokati, i jemi referuar VKB-së nr. 92, datë 25.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, të ndryshuar. Dokumentacioni fizik është përlogaritur 144 fletë të formatit të letrës A4, me vlerë 500 lekë/fletë, si dhe 50 fletë A3, me vlerë 1000 lekë/fletë të njësuara më origjinalin dhe me ngjyra. Megjithatë, gjithë dokumentacioni i kërkuar do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë. Ndërkohë, ankuesit do ti dërgohet përgjigja menjëherë pas publikimit të dokumentacionit.”*

Në vijim, Autoriteti Publik, me emailin e datës 29.12.2023 ka bërë me dije Komisionerin se, me shkresën nr. 2191/2 Prot., datë 22.12.2023 i është kthyer përgjigje ankuesit, duke i referuar ndër të tjera faqen zyrtare, në të cilën gjendet i publikuar dokumentacioni i kërkuar, konkretisht në linkun <https://tepelena.gov.al/drejtoria-e-planifikimit-dhe-kontrollit-te-zhvillimit-te-territorit/>.

Nga shqyrtimi i çështjes së hetimit administrativ të nisur, si dhe konsultimit të legjislacionit të posaçëm, Komisioneri konstaton se, objekti i kërkesës për informacion lidhet me një investim publik, rrjedhimisht interesi për të aksesuar informacion/dokumentacion është i lartë.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, (në vijim “LDI”) parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të*

qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Tepelenë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe parashtrimeve të dhëna nga Autoriteti Publik, Komisioneri konstaton se, lidhur me pikën e parë të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2191/1 Prot., datë 10.11.2023, ka sqaruar se: *“...Lidhur me Lejen për shfrytëzimin e burimeve ujore merret pasi përfundon vepra/objekti dhe uji vihet në shfrytëzim. Kjo në referencë të aplikimit për konformitet që i është dërguar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), nëpërmjet aplikimit nr. AN070220230033 të sistemit elektronik.”.* Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar nuk disponohet nga Autoriteti Publik dhe si rrjedhojë ky kërkim duhet rrëzuar, pasi nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën të 2 të nenit 2 të LDI.

Për sa i përket pikës së dytë dhe të tretë të kërkesës për informacion, nga verifikimi i linkut <https://tepelena.gov.al/drejtoria-e-planifikimit-dhe-kontrollit-te-zhvillimit-te-territorit/>, konstatohet se Autoriteti Publik ka publikuar dokumentacionin e kërkuar në faqen zyrtare. Bazuar në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *“2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:...b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet,* Komisioneri vlerëson se, detyrimi për informim lidhur me këto dy pika të kërkesës për informacion, konsiderohet i përmbushur.

Lidhur me pikën e katërt të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik me shkresën nr. 2191/1 Prot., datë 10.11.2023 ka sqaruar se: *“Procesverbalet e konsultimit publik me banorët e fshatit Mezhgoran të përfaqësuar me prokurë noteriale nga ju, mund t'i drejtoheni Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), meqenëse është institucioni që organizon dëgjuesat para se të lëshojë Lejen Mjedisore apo Vendim për Vlerësimin në Mjedis (VNM).* Argument, të cilin Komisioneri e gjen të pabazuar për shkak se Autoriteti Publik nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, në të cilin parashikohet se: *2. “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10*

ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.

3. Arsyeya e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”

Lidhur me kërkimin e ankuesit në pikën e pestë të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik nuk është shprehur, si dhe nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në pikën e katërt dhe të pestë të kërkesës për informacion, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 2138 Prot., datë 22.11.2023, nga banorët e fshatit Mezhgoran z. , z. , z. dhe z. , përfaqësuar nga av. , kundër Autoritetit Publik, “Bashkia Tepelenë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 26.10.2023, konkretisht në pikën e katërt dhe të pestë (4. *Procesverbalet e konsultimit publik me banorët e fshatit Mezhgoran ku të jenë shënuar qartësisht mendimet dhe pretendimet e tyre.* 5. *Një kopje të dokumentacionit të kompanive “2 T” dhe “GPG Company” në bazë të të cilit ato dy kompani kryejnë punime*), duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 16.01.2024.
3. Rrëzimin e ankesës për informacionin/dokumentacionin e kërkuar në pikën e parë të kërkesës për informacion datë 26.10.2023, konkretisht: (*Lejen për përdorim të burimit Ujor nga Këshilli i Basenit Ujor Vjosë për burimin ujor të fshatit Mezhgoran lidhur me projektin e miratuar për ndërtimin e ujësjellësit Mezhgoran Peshtan*).
4. Të konsiderojë të përmbushur detyrimin për informim të pikës së dytë dhe të tretë të kërkesës për informacion datë 26.10.2023.
5. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijoni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 09.01.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi